

# ***STRATEGJI E KOMUNIKIMIT E KESHILLIT BASHKIAK***

## **A. PARIME TE PERGJITHSHME :**

Keshilli Bashkiak eshte Organi me i rendesishem vendim-marres ne nivel lokal ne interes te ceshtjeve te publikes. Si i tille, ku anetaret e Keshillit Bashkiak kane pergjegjesine ligjore, morale dhe politike per te avancuar ceshtjet e komuniteteve ku jane votuar, Keshilli duhet te kete edhe nje format te qarte, te qendrushem, konciz, transparent dhe te dedikuar mbi menyren se si duhet te nderhyje ne adresimin, reflektimin, pjesemarrjen ne zgjidhje te problemeve te ndryshme te qytetareve. Komunitetet jane te grup-moshave te ndryshme, kategorive shoqerore si komuniteti Rom dhe Egjyptas, komuniteti LGBTQ etj, te cilet perfaqesojne kultura, tradita dhe zakone te ndryshme; si rrjedhoje duhet te kete nje model adresimi te pershtatshem ne varesi te kontekstit dhe nevojave te tyre specifike. Strategjia e Komunikimit ne Keshillin Bashkiak duhet te nis me nderveprimin midis anetareve, ne kuptimin organizativ te grupit te keshilltareve duke patur nje klime bashkepunuese, tolerance dhe komunikimi te hapur , e materializuar kjo edhe ne nje *Kod Etike* i cili do te miratohet me Vendim te Keshillit Bashkiak dhe do te hyje ne Rregulloren e Brendshme te Keshillit. ; vijon me nje format te caktuar ne drejtim te Kryetarit te Bashkise dhe Institucionit te Bashkise, ne kuptimin e gjuhes se sakte institucionale dhe organizimit te hapësirave ne favor te diskutimit dhe adresimit te ceshtjeve, jo vetem 1 ( nje ) here ne muaj ne mbledhjet formale te miratimit te projekt-vendimeve.

Diskutimet dhe kontakti duhet te shtrihen ne frekuenca me te shpeshta per te krijuar alternative ne marrjen e pergjegjesive komunitare. Vete anetaret e Keshillit ( Keshilltaret Bashkiak) jane te ndare ne Zona Zgjedhore dhe Njesi Administrative ku secili e ka te njohur terrenin ku shtrihen komunitetet qe ai perfaqeson, por kjo nuk mjafton. Ne referim te Ligjit 139/2015, cdo Njesi Administrative duhet te krijoje *Keshillat dhe Nderlidhesit Komunitar*. Keto Keshilla dhe Nderlidhes jane nje hallke e rendesishme dhe e qenesishme e funksionimit te mekanizmit nderveprues, orientues dhe delegues nga njesia me e vogel e komunitetit ( qytetari) deri ne njesine me te larte pergjegjese ( Kryetari i Bashkise). Risi e kesaj Strategjie do te jete pikerisht venia ne levizje e ketyre organizmave. Bazuar ne kontekstin tone vendor (organizimit te pushtetit lokal), propozohet qe cdo Njesi Administrative e Bashkise te mund te krijoje 1-2 Keshilla Komunitar, ku cdo anetar i Keshillit Bashkiak te kete ne *patronazhim* minimalisht 1 (nje) Keshill komunitar per te nxitur dhe vene ne eficience funksionin e tyre.

Ne vijueshmeri te kesaj, rekomandohet pasja e nje axhende te mirefillte koordinuese mes aktoreve publik dhe jo publik; nje axhende takimesh me kategori te ndryshme sociale, jo vetem per te mbledhur informacione por edhe per te dhene informacione; jo vetem per te qene prezent

ne takime por edhe per te krijuar hapësira ne pergjigje te problematikave. Anetaret e Keshillit mund dhe duhet te evidentojne njerez me potenciale te grup-moshave dhe profesioneve te ndryshme e ne raste te caktuara te organizojne sesione e forume per t'u dhene hapësire shprehjeje dhe promovimi njerezve te qytetit te cilet kane mundesi te pakta dhe jo vetem.

Qeverisja e mire ne nivel lokal eshte nje pergjegjesi dhe detyre e ligjeruar edhe mbi anetaret e nje Keshilli Bashkiak, ndaj lipset nevoja e krijimit te nje infrastrukture funksionale ne promovimin dhe lancimin e punes dhe aktivitetit te Keshillit BASHKIAK, e shprehur kjo edhe ne formen e nje Strategjie Komunikimi ku perfshihen *objektivat* e Keshillit Bashkiak, *detyrat dhe rolet* e anetareve te Keshillit, *menyra e organizimit* dhe ndarjes ne komisione, hapësirat ligjore per te performuar transparence dhe gjithepershirje, *avancimin* e politikave publike dhe perkthimin e tyre drejt cdo kategorie sociale, *hartimin* e dokumentave strategjik per qytetin, *rekomandimin* e ceshtjeve me rendesi ne nivel qendror dhe *advokimin* e tyre per investime potenciale.

Format ne te cilat qytetaret kane indicje per te perdorur ne interes te ceshtjeve te tyre me baze komunitare mund te jene: **forumet, referendumet mbi baze lagjeje dhe Njesie Administrative, iniciativat qytetare dhe ndertimi i nje axhende nepermjet konsultimeve publike.** Gjenerimi i debateve publike i lejon qytetaret te zhvillojne njohurite e tyre te dijes dhe informacionit, por nga ana tjeter perforcon demokracine lokale.

Filozofia e qeverisjes se hapur nenkupton se proceset e nje organi publik si Keshilli Bashkiak te jene sa me transparente. Kjo transparence eshte e nje rendesie te vecante ne perftimin e besimit publik te qeverisjes. Disa nga menytrat te cilat reflektojne kete filozofi mund te jene :

- ✚ Zhvillimi i mbledhjeve te Keshillit Bashkiak te hapura, me perjashtim te rasteve te caktuara ku ligji lejon qe takimet te jene te nje formati te mbyllur ne sesione te mbyllura;
- ✚ Lejimi i publikut te marr pjese ne mbledhjet e Keshillit ku te parashikohet nje minutazh i hapur per diskutim nga ana e grupeve te interesit apo qytetareve pjesemarres ne mbledhje;
- ✚ Mbajta e regjistrimeve publike nepermjet Livestream, me perjashtim te rasteve kur ligji nuk e autorizon regjistrimin.

## **B. KESHILLI BASHKIAK NE RAPORT ME VETEN**

- Nje Strategji Komunikimi duhet te perfshije nje **Zedhenes te Keshillit Bashkiak**, nje imazh i cili te dedikohet ne organizimin e eventeve, axhendes, marredhenieve me mediat ne interes te punes se anetareve te Keshillit. Ky mund te jete nje person brenda Keshillit ose dikush tjeter nga profesionistet e qytetit i cili e merr persiper ne menyre vullnetare te perfaqesojte imazhin e Keshillit Bashkiak ne prononcime mediatike. Ne fund te vitit kalendarik, ky person do te kete edhe stimuj moral dhe profesional per detyren e realizuar.
- Keshilli i Bashkise duhet te kete nje **logo, dizajn** dhe nje moto te qarte, te cilat identifikojne Keshillin ne dokumentat dhe faqet e Web-it ku do te publikohen materialet e veta. Rekomandohet shpallja e nje konkursi publik per te realizuar logon dhe percaktuar moton e Keshillit Bashkiak te qytetit.
- Keshilli duhet te prodhoje nje **Dokument Strategjik** ne koordinim edhe me ekspert te politikes dhe medias per tja prezantuar publikut dhe institucionit te Bashkise perkatese ; nje dokument i cili shpreh *vizionin, objektivat, pritshmerite, rolet dhe pergjegjesite, qellimin* e anetareve te X mandati legjislativ, pertej atyre c'fare parashikon subjekti politik ku ata marrin pjese .
- Keshilli duhet te prodhoje 1 here ne muaj **Newsletter** (reviste e dixhitalizuar informative) e cila te permbledh gjithte aktivitetin e Keshillit dhe te shperndahet elektronikisht ne cdo adrese-emaili te disponueshme, ne menyre te tille qe informacioni te jete vizibel, i aksesueshem, i arritshem, transparent ne sa me shume qytetar dhe pale te interesuara. Kjo shperndarje e informacionit ne rruge elektronike krijon afrimitet me qytetarin dhe e ve ate ne dijeni te zhvillimeve qe ndodhin ne qytet. Ne kete menyre rrit pjesemarrjen indirekte dhe e stimulon qytetarin te kete me shume interes dhe vemendje per pjesemarrje me te gjere ne vendim-marrje.
- Keshilli duhet te kete prezantim ne rrjete sociale, si **Web, e-mail , Facebook- Twitter- Instagram- Youtube** ne menyre te tille qe ky forum i anetareve te perfshije ne aktivitetin e tij te gjitha grup-moshat per t'i bere pjese te komenteve dhe sugjerimeve qe mund te vijne prej tyre; per te patur kontakt te drejtperdrejte dhe per t'u angazhuar personalisht secili prej anetareve sipas zonave te tyre perfaqesuese. Ne brendesi te faqes se Facebook mund te krijohet nje faqe "**submit story idea**" per te mundesuar kreativitetin e cdo pjesemarrresi ne rrjete sociale; monitorimi i *like* dhe *share* per ceshtje te caktuara dhe avancimi i atyre ceshtjeve te cilat rezultojne te kene impakt me te madh ne komunitet.

Eshte me rendesi krijimi nje profili per cdo anetar te Keshillit Bashkiak si dhe te afishohen kontaktet e tij te punes per te rritur vizibilitetin.

- Nepermjet ndarjes ne Komisione te vecanta si Komisioni per Ceshtjet e Ekonomise Finances dhe privatizimet ; Komisioni i Mandateve dhe Rregullores; Komisioni i Sherbimeve dhe Strehimit ; Komisioni per arsimin, kulturen, sportet dhe OJF/te; Komisioni per barazine gjinore dhe politikave sociale; Komisioni juridik, i rendit publik dhe i mbrotjes; Komisioni per zhvillimin urbanistik dhe ndertimet; Komisioni per mbrojtjen e mjedisit, sherbimeve shendetesore dhe zhvillimin e turizmit; Komisioni per informacionin dhe marredheniet me publikun; Komisioni per marredheniet me jashte, Komisioni per Mbikqyrjen, kontrollin dhe nenshkrimin e procesverbaleve te mbledhjeve, Komisioni per zhvillimet bujqesore dhe blegtorale dhe agrobiznesit, anetaret e Keshillit Bashkiak perforcjne grupet e interesit sipas natyres dhe tipologjise se ceshtjeve ku ata jane ekspert apo aktivist te fushes. Prane tyre mund te sherbeje edhe nje grup *keshillimor* per t'i asistuar apo facilituar ne ceshtje me interes publik qe kerkojne teknikalitet specifik. Eshte me rendesi qe cdo Komision i Keshillit te avancoje nepermjet nje axhende ceshtjesh, tematikash dhe ta beje ate publike nepermjet takimeve me grupet e interesit. Kete axhende e publikon ne rrjetet sociale dhe vendos nje hapesire per komente nga publiku.
- Keshilli Bashkiak duhet te angazhohet me profesioniste te qytetit, per te marr mendimet/ vleresimet/ opinionet e tyre ne lidhje me publikimin dhe hartimin e dokumentave politik te cilet mund te parashtrihen para Kryetarit te Bashkise; te adresohen ne forme lobingjesh ne donator te ndryshem per projekte te mundshme.
- Prodhimi i nje raporti te detajuar cdo 1 ( nje) vit, ku te organizohen dite te dedikuara me evente promovuese dhe perfshirese mbi punen dhe sherbimet qe ofron Keshilli Bashkiak;
- Zhvillimi i sondazheve formale dhe informale per te kategorizuar ceshtjet me te nxehta te komunitetit dhe perceptimin e popullsisë ne lidhje me ceshtje te caktuara te cilat mund te lancohen per t'u buxhetuar ne menyre me korrekte nga ana e Bashkise.

### **C. KESHILLI BASHKIAK NE RAPORT ME INSTITUCIONIN E BASHKISE**

- ✚ *Takime periodike* me Kryetarin e Bashkise pas takimeve te realizuara nga vete Komisionet specifike te Keshillit me keshillat komunitar ose grupet e interesit, dhe pas nje procesi filtrimi te ketyre problematikave, mund te marrin takime ne grup ose te personalizuar ne varesi te ceshtjeve me interes publik. Publikimi online i ceshtjeve te shqyrtuara dhe pikave te arritura pas cdo takimi.
- ✚ Organizimi i *mini-forumeve* midis Drejtorive dhe Departamenteve te Bashkise dhe anetareve te Keshillit ku te diskutohen ndryshimet ligjore , koordinohen ceshtjet qe mund te jene prioritet i Bashkise dhe atyre qe vijne nga kontakti i vazhdueshem me qytetaret.
- ✚ Nepermjet kryerjes se sondazheve apo intervistimeve me grupe interesi, mund t'i prezantojne per shqyrtim dhe zgjidhje Kryetarit te Bashkise dhe Stafit Drejtues, menyra te reja metodologjike te punes ne permbushje te vullnetit te shumices dhe pergjigjes kundrejt problemit me specifik te komunitetit.

### **D. KESHILLI BASHKIAK NE RAPORT ME MEDIAN**

- ✚ Te jene te aksesueshem ndaj kerkeses se medias per informacion;
- ✚ Te jene te pergatitur dhe kompetent per ceshtjet qe do te trajtojne;
- ✚ Te jene miqesor dhe bashkepunues;
- ✚ Te jene te vertete ;
- ✚ Te jene konciz;
- ✚ Te delegojne nje person pergjegjes per mediat i cili do te koordinoje intervistat, pjesemarrjen ne emisione ;

### **E. KESHILLI BASHKIAK NE RAPORT ME ZONAT RURALE**

- ✚ Per efekt lehtesimi dhe fokusi, Keshilli Bashkiak te delegoje nje anetar pergjegjes per ceshtjet e zonave rurale. Ky person te informoje dhe raportoje ne menyre te vazhdueshme te koleget e Keshillit mbi kerkesat dhe problematikat qe adresohen prej komuniteteve ne zonat rurale. Propozohet qe ky anetar Keshilli i deleguar, te marr kontakt dhe takim periodik me Kryetar te Njesive Administrative te cilet menaxhojne 36 fshtatrat e Bashkise Vlore. Ky anetar do te raportoje me shkrim ne fund te ketij turi takimesh prane Sekretariatit te Keshillit Bashkiak per te koordinuar dhe adresuar keto nevoja dhe

problematika prane Institucionit te Bashkise dhe Keshillit Bashkiak per te miratuar projekte ne favor te zgjidhjes se tyre.

## **F. KESHILLI BASHKIAK NE RAPORT ME UNIVERSITETIN DHE TE RINJTE**

Duke e konsideruar Universitetin dhe te rinjte nje grupim strategjik, ne kete Strategji Komunikimi do i dedikohet nje pjese e vecante duke propozuar disa menyra koordinimi:

- + Organizimi i takimeve periodike i Komisionit te Edukimit te Keshillit Bashkiak me Senatin e Studenteve ne Universitetin dhe me senatet e shkollave te mesme te qytetit;
- + Krijimi i hapësirave per internship ( praktika studentore) prane Keshillit Bashkiak per studentet e interesuar per qeverisjen vendore;
- + Cdo anetar i Keshillit Bashkiak mund te kete nje student si asistent ne menyre vullnetare per ta bere pjese te punes se tij mujore;
- + Organizimi i forumeve dhe debateve publike per ceshtjet me interes publik; afishimi i diskutimeve ne rrjete sociale dhe ne Newsletter-in e permuajshem;
- + Organizimi i shkembimeve dhe partneriteteve me te rinj te qyteteve te tjera per te diskutuar dhe krahasuar pikepamje per te perforcuar kritiken dhe perspektiven;
- + Lobimi prane Bashkise dhe donatoreve te ndryshem per te ofruar bursa studimi per te rinjte e talentuar dhe ata ne pamundesesi ekonomike ne zhvillim te potencialeve krijuese;

## **G. KESHILLI BASHKIAK NE RAPORT ME HOMOLOGET E HUAJ DHE VENDAS**

- + Pjesemarrja aktive ne forume dhe projekte te ndryshme ;
- + Delegimi i *nje personi pergjegjes* per marredheniet me jashte ;
- + Organizimi i pervitshem i nje *Konference Nderkombetare* per shkembimin e praktikave dhe metodologjise se punes se Keshillit Bashkiak;
- + Lidhja e *partneriteteve* me Keshillat Bashkiak te vendeve te Bashkimit European;



# STRUKTURA E SEKRETARIATIT TE KESHILLIT



